




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.03.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3906/15, për z. Safet Idrizi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Safet Idrizi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas pranimit të informacionit për dyshimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit sipas të cilit zyrtari i lartë z. Safet Idrizi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, është duke ushtruar edhe një funksion menaxherial në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri.

Zyrtari i lartë z. Idrizi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë kanë organizuara një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast z. Idrizi, është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit për gjendje të mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Idrizi, gjatë këtij takimi ka deklaruar se ushtron edhe funksionin Specialist i Mjekësisë Familjare – Përgjegjës i Shëndetit Publik në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri.

Pas sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm lidhur me rastin, është vërtetuar se zyrtari i lartë z. Idrizi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri ushtron funksionin Specialist i Mjekësisë Familjare – Përgjegjës i Shëndetit Publik në QKMF - Vushtrri, e që ushtrimi i njëkohësishëm i funksioneve të lartëcekura nuk paraqet konflikt interesi.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik nr.04/L-051, nuk ka përcaktuar ndonjë kufizim.

Po ashtu ushtrimi i funksioneve të lartëcekura nuk bie ndesh me nenin 65 (paragrafi 2), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 në të cilin shprehimisht thuhet:

Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të kuvendit të Republikës së Kosovës apo kuvendit të komunës të komunës ku ata punojnë.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të ketë parasyshë deklarin rast për rast të interesave private lidhur me vendimarrjen e caktuar neni 13 (paragrafi 1,2,3), të Ligjit nr.04/L-051.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

